



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:035080

Datë: 03.06.2024

Numri i dokumentit: 05770636

KPPP.nr. 836/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit “Climasan” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810196362 dhe seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson shoqëria e avokatëve “Legus” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, kundër debitorit A.S. B.I., me numër unik identifikues 811144328 dhe seli në Gjakovë, rr. “Skënderbeu”, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson shoqëria e avokatëve “Vokshi & Lata”, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas prapësimit të debitorit ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 5/22, i lejuar me datë 12.01.2022, nga Përbaruesi Privat Mubarak Shumolli, me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 03.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i prapësimi i debitorit A.S. B.I., me numër unik identifikues 811144328 dhe seli në Gjakovë, ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 5/22, i lejuar me datë 12.01.2022, nga Përbaruesi Privat Mubarak Shumolli SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme, Faturës nr. 21-SHV01-C68-3, e datës 12.11.2021; Faturës nr. 21-SHV01-C68-4, e datës 12.11.2021; Faturës nr. 21-SHV01-C68-2, e datës 13.09.2021, si dhe; Faturës nr. 19-SHV01-C68-1, e datës 30.07.2021, ka lejuar Urdhrit Përbarimor P.nr. 5/22, të datës 12.01.2022, me të cilin është lejuar përbarimi ndaj debitorit për arkëtimin e borxhit në shumë prej EUR 20,789.38, me kamatë prej 8%, duke filluar nga data e arritshmërisë për pagesë, data 12.11.2021, e deri në pagesën definitive, shpenzimet e procedurës përbarimore si dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përbarim në lartësi prej EUR 208.00.

Kundër këtij urdhri, debitori me datë 25.01.2022, ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor në tërësi, me arsyetim se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri janë lëshuar për punë të cilat nuk janë përfunduar në tërësi nga ana e kreditorit, i cili fakt nuk është kontestues as nga ana e kreditorit. Më tej, ka shtuar se kreditori ka refuzuar që të bëjë vlerësimin e punëve të përfunduara dhe ka iniciuar procedurë përmbarimore për përmbushjen e pagesës për punë për të cilat nuk është bërë pranimi në mënyrë të rregullt. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta pranoj si të bazuar, ashtu që urdhri përmbarimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim ka theksuar se urdhri është lejuar në përputhje me dispozitat nga neni 22, 27, 29 dhe 38 të LPP-së. Ndërsa, në raport me pretendimet e debitorit, ka theksuar se asnjë faturë nuk është lëshuar për punë të papërfunduara, dhe se të gjitha faturat kanë të bëjnë vetëm për punët të cilat kreditori i ka kryer për nevojat dhe sipas kërkesës së debitorit. Më tej, ka theksuar se të gjitha faturat janë lëshuar nga kreditori dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori, i cili nuk i ka kundërshtuar brenda afateve të përcaktuara me dispozitat ligjore, mirëpo të njëjtat i ka kundërshtuar vetëm me datën 30.12.2021 përmes email. Në fund, ka theksuar se prapësimi i debitorit nuk është i mbështetur me prova, ashtu siç kërkohet me nenin 69, paragrafi 4 të LPP-së. Gjykatës, i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, me Aktvendimin KPPP.nr. 2054/2022, të datës 20.09.2023, ka hedhur poshtë si të pasafatshëm prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj urdhrin përmbarimor P.nr. 5/2022, të lejuar me datë 12.01.2022, nga Përmbaruesi Privat Mubarak Shumolli.

Ndaj këtij aktvendimi, debitori ka paraqitur ankesë, ndërsa Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.Dh.Sh.II.nr. 324/2024, të datës 07.05.2024, ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit, ndërsa Aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë KPPP.nr. 2054/2022, të datës 20.09.2023 e ka anuluar dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje pranë Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale.

Në rivendosje, gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke i marrë për bazë edhe sugjerimet e gjykatës së shkallës së dytë, në mbështetje të dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP),

gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Neni 29, paragrafi 1 i LPP-së, përcakton se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa, pika 1.3 e njëjtit nen ka përcaktuar faturën si dokument të besueshme sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, në paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anën tjetër, me nenin 37 të LPP-së parashihet se: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*

Tutje, sipas nenit 38, paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, *Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit. 2. Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.*

Gjykata, duke ju referuar dispozitave të cekura si më lartë, gjeti se dokumenti, përkatësisht Fatura nr. 21-SHV01-C68-3, e datës 12.11.2021; Fatura nr. 21-SHV01-C68-4, e datës 12.11.2021; Fatura nr. 21-SHV01-C68-2, e datës 13.09.2021, si dhe; Fatura nr. 19-SHV01-C68-1, e datës 30.07.2021, mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri, nuk janë deponuar në origjinal apo kopje të vërtetuar siç kërkohet me nenin 37 të LPP-së.

Në këtë drejtim, rezulton se propozimi për përmbarim mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, përmban të meta ngase në propozim nuk është treguar dokumenti origjinal apo kopje e vërtetuar mbi bazën e së cilit është iniciuar procedura përmbarimore, ashtu siç përcaktohet edhe me dispozitën nga neni 38, paragrafi 1 të LPP-së, me të cilën parashihet se propozimi për përmbarim, ndër të tjera, duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet, dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm.

Në anën tjetër, sipas dispozitës nga neni 43, paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se “*Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim*”.

Andaj, nga të lartcekurat gjykata gjen se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbarimit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbarim nuk i është bashkangjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit të besueshëm - faturës, dhe përmbarim të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrin.

Gjykata vlerëson se është detyrim ligjor i përmbaruesit privat që, para lejimi të urdhrin përmbarimor, të vlerësoj nëse propozimi për përmbarim i paraqitur nga kreditori i plotëson kërkesat nga neni 38, paragrafi 1 i LPP-së, dhe në rast se propozimi nuk është paraqitur konform kësaj dispozite, atëherë duhet që të veproj sipas nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, lidhur me nenin 102, paragrafi 1 të LPK-së, duke e ftuar kreditorin që të bëjë plotësimin e propozimit për përmbarim duke bashkangjitur origjinalin apo kopjen e vërtetuar të dokumentit të besueshëm brenda afatit të paraparë ligjor.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 836/24, datë 03.06.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.